



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:099143
Datë: 21.01.2025
Numri i dokumentit: 06736549

C.nr.1517/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Z. J. nga fshati F., komuna e M. J., të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Safet Voca, avokat nga Mitrovica, kundër të paditurit B. B., nga fshati Z. i P., komuna e M. J., me objekt konteksti vërtetimin e pronësisë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 21.01.2025 mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET** e tërhequr padia e paditëses Z. J. nga fshati F., komuna e M. J., e ushtruar kundër të paditurit B. B., nga fshati Z. i P., komuna e M. J., me objekt konteksti vërtetimin e pronësisë, në këtë çështje juridike kontestimore.
- II.** Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësja Z. J. nga fshati F., komuna e M. J., në këtë gjykatë, përmes përfaqësuesit të saj të autorizuar ka ushtruar padi kundër të paditurit B. B., nga fshati Z. i P., komuna e M. J. me objekt konteksti vërtetimin e pronësisë.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës ... e ka njoftuar gjykatën se e tërheq padinë dhe kërkesëpadinë në këtë çështje juridike, me arsyetimin se paditësja nuk është më e interesuar që këtë çështje ta rregulloj përmes procedurës gjyqësore.

Gjykata gjen se me dispozitën e nenit 261 par.3 të Ligjit Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*. Në rastin konkret, gjykata duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, vendosi si në pikën I të dispozitivit.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil

C.nr.1517/2024 më datë 21.01.2025

Gj y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.